



IOM International Organization for Migration  
OIM Organisation Internationale pour les Migrations  
OIM Organización Internacional para las Migraciones

## Programi për Kthim të Asistuar Vullnetar – PKAV

### Pyetje – Përgjegje të Shpeshta

#### 1) Kush mund të paraqet kërkesën për Program për Kthim të Asistuar Vullnetar?

IOM ofron asistencë azilkërkuesve dhe migrantëve jo anëtar të AEE\* të cilët dëshirojnë të kthehen përgjithmonë në vendlindje port ë cilët nuk kanë mundësi financiare dhe/ose nuk kanë dokumente përkatëse për kthim.

#### 2) Cilat janë përparësitë e programit?

Qëllimi i Programit për Kthim të Asistuar Vullnetar është të ndihmojë individët të kthehen në vendlindje të tyre në mënyrë të organizuar dhe me dinjitet. Përmes IOM-it udhëtoni si çdo pasangjer tjetër në mënyrë të zakonshme. Arsyet e qëndrimit tuaj në Irlandë dhe arsyeja e kthimit do të mbesin sekret dhe nuk do të ipen askuj jashtë proqesit vullnetar të kthimit.

#### 3) A ndikon kthimi vullnetar në mundësin time të hyrjes legale në shtet?

Nëse ktheheni vullnetarisht para se të ipet urdhësa e deportimit dhe nëse nuk keni ndonjë akt të pashqyrtuar gjyqësor në Irlandë, mund të aplikoni për hyrje legale në Irlandë për qëllim pune, studimi etj.

#### 4) A do të më vulosët pasaporta ose dokumenti i udhëtimit nga imigracioni Irlandez?

Nëse ktheheni përmes programit të IOM-it, pasaporta nuk do të vulosët me rastin e largimit të Irlandës.

#### 5) Cila është procedura?

- Fillimisht plotësoni kërkesën dhe nënshkruani deklaratën për kthim vullnetar.
- Pasi që të marrim kërkesën ne i dërgojmë detajet në Departament të Drejtësisë, Barazisë dhe Reformës Ligjore (Department of Justice, Equality and Law Reform) dhe i bëjmë me dije që keni paraqitë kërkesë për kthim vullnetar në Programin për Kthim të Asistuar Vullnetar.
- Departamentit të Drejtësisë, Barazisë dhe Reformës Ligjore i duhet të miratojë kërkesën e çdo kandidati për program të kthimit të asistuar vullnetar.
- Nëse kërkesa miratohet, dhe nuk keni dokument të vlefshëm udhëtimi të lëshuar nga shteti juaj, IOM-i do të ndihmojë, mundësisht, në nxjerrjen e dokumentacionit të nevojshëm për kthim në vendlindje.

\* AEE (Area Europiane Ekonomike) përbëhet nga shtetet anëtare të Unionit Europian përfshirë Ajsllanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia.

## FAQs – Albanian

- Pastaj do të diskutojmë së bashku për datën e përshtatshme të udhëtimit. IOM-i nuk punon gjatë fundjavës, prandaj dita e udhëtimit duhet të jetë gjatë ditëve të punës. Keni parasysh që IOM-i bën shumë kthime gjatë javës dhe kthimi juaj duhet të bëhet sipas orarit të IOM-it. IOM-i do të përpiqet të plotësoj datën e cila ju përgjigjet, por kjo nganjëherë nuk është e mundur.
- Ne do të prejmë biletën e udhëtimit dhe po që se paraqitet nevoja, do të rregullojmë visat transitorë për shtetet nëpër të cilat udhëtoni.
- Ditën e udhëtimit do të takohemi në aeroport dhe do t'ju asistojmë gjersa të niseni.
- Githashtu nëse keni nevojë, ne mund të ndihmojmë me asistencë në vendlindje.

### **6) Nëse kërkoj të kthehem përmes PKAV, si do të ndikojë kjo në kërkesën time për azil?**

PKAV financohet nga Departamenti i Drejtësisë, Barazisë dhe Reformës Ligjore i cili vendos a është aplikuesi i përshtatshëm për kthim përmes këtij programi.

Nëse vendosni të ktheheni, duheni të tërheqni kërkesën e juaj për azil para se të paraqesni kërkesën për Kthim Vullnetar ashtu që Departamenti i Drejtësisë të shqyrtoj kërkesën tuaj.

Do të kërkohet nga ju të nënshkruani deklaratën për kthim vullnetar, e cila e mbron natyrën vullnetare të kthimit të juaj.

Nëse ndroni mendjen për kthim, kurdoher para nisjes dhe dëshironi të vazhdoni procesin e azil-kërkimit, duheni të kërkoni ndihmë legale për opsionet të cilat mund të jenë në dispozicion.

### **7) Çka ndodhë kur arrij në shtetin tim?**

Nëse keni nevojë për asistencë nga IOM-i në aeroport në shtetin tuaj, ne mund t'ju ndihmojmë tuaj, ne mund t'ju ndihmojmë. Në disa shtet IOM-i nuk ka përfaqësi prandaj asistencë në aeroport mund të jetë e pamundshme.

Nëse shtëpia juaj është larg aeroportit, zyra lokale e IOM-it mund të siguroj biletë udhëtimi.

### **8) Sa bagazh mund të sjellë me vete?**

Kjo varet nga kompania ajrore me të cilën do të udhëtoni. Zakonisht lejohen 20kg. **Nëse keni më shumë ju do të paguani. Teprica e bagazhit është shumë e shtrenjtë. IOM nuk është përgjegjës për pagesën e bagazhit të tepruar. Nëse e humbasni fluturimin për shkak të qështjes së bagazhit të tepruar, IOM-i sipas të gjitha gjasave NUK do të mund të prrej biletë tjetër.**

Ju sygjerojmë që me kohë të organizoni kargo-dërgesën e tepricës së bagazhit tuaj sepse ju kushton më lirë. Kompania ajrore nuk pranon asnjë valixhe e cila peshon më shumë se 32kg. IOM-i do t'ju informoj se sa peshë keni të drejtë të marrni me vete.

### **9) Sa kohë do të zgjasë organizimi i udhëtimit tim?**

IOM gjithmonë mundohet të plotësojë kërkesat e juaja dhe të gjejë rrugën më të përshtatshme për kthim. Mesatarisht kohëzgjatja e kthimit është 2-4 javë. Varësisht nga faktor të ndryshëm si psh. Departamenti i Drejtësisë, Barazisë dhe Reformës Ligjore, a do të ketë biletë fluturimi, apo ndonjë nevojë speciale që duhet të merret parasysh para udhëtimit.